

SI TË MBRONI VETEN DHE FAMILJEN TUAJ

● Gripi i shpendëve është një sëmundje ngjitëse e rrezikshme e cila zakonisht prek zogjtë shtegtarë por edhe ato shtëpiake si rosat, pulat, patat dhe gjelat e detit.



● Ai përhapet nga kontakti direkt me shpendë të sëmurë ose sekrecionet dhe glasat e shpendëve (zogjve) të infektuar.

KUJDES !!

- Mos prekni shpendë të ngordhur ose të sëmurë si dhe glasat e tyre pa mjete të posaçme si doreza, syze, maskë etj.
- Njoftoni personelin veterinar ose shëndetësor për çdo shpend të ngordhur ose të sëmurë.
- Mbajini zogjtë në kafaze ose në një zonë të rrethuar me rrjeta teli të mbuluar dhe ushqejini vetë ato.
- Dezinfektoni qoftë edhe me gëlqere të pashuar plehun dhe ambientet ku rriten shpendët.
- **Dhe më e rëndësishmja nga të gjitha! Përmirësoni higjienën personale, lani duart sa më shpesh me ujë dhe sapun.**

KËSHTU NUK SËMURENI



● Përdorni vezë të padëmtuara.



● Lani vezët me sapun dhe zieni mirë ato para se t'i konsumoni.



● Nëse i preferoni të skuqura sigurohuni që të jenë të skuqura mirë dhe e verdha të mos jetë e lëngshme.



● Lani duart mirë me ujë dhe sapun pasi prekni vezët.



● Mishi i pulës i zier ose i pjekur mirë nuk përbën asnjë rrezik për shëndetin tuaj.



● Gatujeni pulën në temperaturë të lartë për të eliminuar mikrobet.



● Lani duart mirë me ujë dhe sapun para dhe pas përgatitjes së pulës për gatim.



● Mos përdorni të njëjtën enë apo pjatë për pulën e pagatuar dhe atë të gatuar.



Vepro si më sipër. Mos nënvleftëso rregulloren e gatimit. Kështu fëmijët dhe familja juaj nuk rrezikohen nga sëmundja.

KUJDES!



Të dashur fëmijë!

Në e dimë se ju pëlqen shumë të luani me zogjtë, por duke ditur rrezikun e gripit të shpendëve në asnjë rast mos ju afroni atyre kur luani në oborret e shtëpive apo kur dilni shëtitje.

NE DO TE LUAJMË PËRSËRI!



Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.
ISHP IKV.

Mbështetur nga
OBSh, PNUD, UNICEF, USAID



FËMIJË: A E DINI Ç'ËSHTË GRIPI I SHPENDËVE ?



Gripi i shpendëve është një sëmundje ngjitëse e rrezikshme e cila shkaktohet nga virusi (H5N1)

Ai prek kryesisht zogjtë shtegtarë dhe shpendët shtëpiake, si rosat, pulat, patat, gjelat e detit etj.

Por gripi i shpendëve prek edhe njerëzit, pra mund të sëmurëni dhe

JU